

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**SHËRBIME SOCIALE DHE**  
**SHËNDETËSORE**

**Niveli III**  
**(1 vjeçar)**

**Kodi: O-III-12**

Miratoi:

**MINISTRI**

**MYQEREM TAJAJ**

**Tiranë, 2012**

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**
  1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.
  3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me organizimin, administrimin dhe drejtimin e qendrave që ofrojnë shërbime social-shëndetsore, bizneset sociale, fondacionet, shoqata (OJF) si dhe projektet komunitare që fokusohen në përmirësimin e jetës sociale, mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të njerëzve në nevojë, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit II të drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”,

niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërën nga profilet mësimore të nivelit II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion që lidhen me veprimtaritë profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të zbatojë standartet teknike të profesionit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të kryejë procedurat e duhura për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor .
- Të menaxhojë përkujdesjen shëndetësore dhe ndihmën sociale në një qendër të shërbimit social-shëndetësor.
- Të kryejë mirëmbajtjen e qendrës së shërbimit social - shëndetësor dhe administrimin e dokumentacionit të saj.
- Të kryejë procedurat për rekrutimin e stafit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Të aftësohet për ndërtimin e network-ut dhe pjesëmarrjen në shoqërinë civile.

- Të hartojë dhe zbatojë një plan marketing në biznesin social shëndetësor.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime të profesionit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

**4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e menaxherit të veprimtarive për shërbimet sociale dhe shëndetësore. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në të gjitha bizneset sociale, qendra ditore ose rezidenciale të të moshuarve, të fëmijëve dhe të rinjve, OJF, shoqata dhe fondacione , projekte komunitare si dhe ne veprimtari që kanë lidhje me shërbimet sociale dhe shëndetësore për njerëzit në nevojë.

Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

**III. Plani mësimor për drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”,  
niveli III.**

<b>Plani mësimor për drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.</b>			
<b>Nr</b>	<b>Kodi</b>	<b>Lëndët dhe modulet mësimore</b>	<b>Orët javore/ vjetore</b>
			<b>Klasa 13</b>
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>15/17</b> (510/578)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2
2		Gjuhë e huaj	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)
4		Histori	2
5		Gjeografi	2
6		Matematikë	2
7		Biologji	2
8		Teknologji informimi e komunikimi	1
9		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti)	2
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>9 (306)</b>
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-17-276-12	Ekonomi shëndeti	3
4	L-17-277-12	Kuadri ligjor në shërbimin social-shëndetësor	2
5	L-26-278-12	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>6 (204)</b>
1	M-17-826-12	Hapja dhe mbyllja e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor	33
2	M-17-827-12	Menaxhimi i përkujdesjes shëndetësore në një qendër të shërbimit social-shëndetësor	36
3	M-17-828-12	Mirëmbajtja e qendrës së shërbimit social-shëndetësor dhe administrimi i dokumentacionit të saj	33
4	M-17-829-12	Rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	33
5	M-20-830-12	Ndërtimi i network-ut social-shëndetësor dhe pjesëmarrja në shoqërinë civile	33
6	M-17-831-12	Zhvillimi i marketingut në biznesin social-shëndetësor	36
		<b>Gjithsej A+B+C</b>	<b>30/32</b> (1020/ 1088)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASH.

## **VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e menaxherit të veprimtarive për shërbimet sociale dhe shëndetësore, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 13 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Sipërmarrja dhe menaxhimi	<b>4 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	<b>5 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Aftësitë menaxheriale	<b>8 orë</b>
<b>Tema 4</b>	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	<b>5 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Menaxhimi i burimeve njerëzore	<b>7 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Menaxhimi i informacionit	<b>6 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Menaxhimi marketing	<b>5 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Menaxhimi financiar	<b>9 orë</b>
<b>Tema 9</b>	Zhvillimi i një plani biznesi	<b>7 orë</b>
<b>Tema 10</b>	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	<b>7 orë</b>
<b>Tema 11</b>	Kuadri ligjor dhe taksat	<b>5 orë</b>

## 2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 34 orë

### • Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 34 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	<b>2 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	<b>3 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	<b>3 orë</b>
<b>Tema 4</b>	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	<b>4 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	<b>4 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Monitorimi i burimeve mjedisore	<b>4 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	<b>2 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	<b>3 orë</b>
<b>Tema 9</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	<b>3 orë</b>
<b>Tema 10</b>	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	<b>6 orë</b>

## 3. Lënda “Ekonomi shëndeti” (L-17-276-12). Kl. 13-102 orë

### • Synimet e lëndës “Ekonomi shëndeti ”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekonomi shëndeti ”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë përmbajtjen dhe rëndësinë e ekonomisë së shëndetit.
- Të përshkruajnë planifikimin e gjëndjes shëndetësore, sektorin shëndetësor dhe zhvillimin kombëtar.
- Të shpjegojnë si funksionojnë kërkesat dhe ofertat në sektorin shëndetësor.
- Të përshkruajnë shpenzimet dhe kontrollin e shpenzimeve në sektorin shëndetësor.
- Të shpjegojnë finacimin e sektorit shëndetësor
- Të tregojnë metodat dhe instrumentat e vlerësimit ekonomik.

- Të përshkruajnë si bëhen pagesat e personelit shëndetësor.
- Të shpjegojnë veçoritë e tregut shëndetësor dhe liberalizimin e tij.
- Të përshkruajnë sistemet shëndetësore në bashkimin evropian.
- Të tregojnë mjedisin ideologjik në sektorin shëndetësor.
- Të përshkruajnë vlerësimet e përgjithshme mbi shëndetin.
- Të shpjegojnë konceptet dhe parimet e përgjithshme të shëndetit publik.
- Të përshkruajnë parimet bazë të promocionit shëndetësor.
- Të listojnë detyrat e shëndetit publik.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekonomi shëndeti”, kl.13 - 102 orë**

<b>Tema 1</b>	Hyrje në ekonominë e shëndetit	<b>10 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Planifikimi i gjëndjes shëndetësore, sektori shëndetësor dhe zhvillimi kombëtar	<b>9 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Kërkesa dhe oferta në sektorin shëndetësor.	<b>9 orë</b>
<b>Tema 4</b>	Shpenzimet dhe kontrolli i shpenzimeve në sektorin shëndetësor	<b>12 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Finacimi i sektorit shëndetësor	<b>8 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Metodat dhe instrumentat e vlerësimit ekonomik	<b>4 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Pagesat e personelit shëndetësor	<b>4 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Tregu shëndetësor dhe liberalizimi i tij	<b>4 orë</b>
<b>Tema 9</b>	Sistemet shëndetësore në bashkimin evropian	<b>8 orë</b>
<b>Tema 10</b>	Mjedi i ideologjik në sektorin shëndetësor.	<b>6 orë</b>
<b>Tema 11</b>	Vlerësime të përgjithshme mbi shëndetin	<b>6 orë</b>
<b>Tema 12</b>	Konceptet dhe parimet e përgjithshme të shëndetit publik	<b>8 orë</b>
<b>Tema 13</b>	Parimet bazë të promocionit shëndetësor	<b>6 orë</b>
<b>Tema 14</b>	Detyrat e shëndetit publik	<b>8 orë</b>

**4. Lënda “Kuatr i ligjor në shërbimin social-shëndetësor” (L-17-277-12). Kl. 13-68 orë**

• **Synimet e lëndës “ Kuatr i ligjor në shërbimin social-shëndetësor”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Kuatr i ligjor në shërbimin social-shëndetësor”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuadrin ligjor për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
- Të përshkruajnë sistemin e sigurimeve shoqërore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor kombëtar në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor.
- Të përshkruajnë sistemin e sigurimeve të kujdesit shëndetësor
- Të shpjegojnë kuadrin ligjor mbi vlerësimin dhe komisionimin e aftësisë së kufizuar.
- Të përshkruajnë strategjinë kombëtare të personave me aftësi të kufizuar.
- Të përshkruajnë politikën e zhvillimit të shërbimeve të shëndetit mendor.
- Të tregojnë politikën e përfshirjes sociale për fëmijë dhe financimin e tyre.
- Të përshkruajnë strategjinë kombëtare për fëmijë.
- Të tregojnë strategjinë kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje.
- Të shpjegojnë stigmatizimin dhe politikën anti-drogë

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Kuatrri ligjor në shërbimin social-shëndetësor”, kl.13 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Kuatrri ligjor për ndihmën dhe shërbimet shoqërore	<b>4 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Sistemi i sigurimeve shoqërore	<b>8 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Kuatrri ligjor kombëtar në fushën e shërbimit të kujdesit shëndetësor.	<b>4 orë</b>
<b>Tema 4</b>	Sistemi i sigurimeve të kujdesit shëndetësor	<b>8 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Kuatrri ligjor mbi vlerësimin dhe komisionimin e aftësisë së kufizuar	<b>6 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Strategjia kombëtare e personave me aftësi të kufizuar	<b>8 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Politikat e zhvillimit të shërbimeve të shëndetit mendor	<b>4 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Politikat e përfshirjes sociale për fëmijë dhe financimi i tyre	<b>4 orë</b>
<b>Tema 9</b>	Strategjia kombëtare për fëmijë	<b>6 orë</b>
<b>Tema 10</b>	Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje.	<b>8 orë</b>
<b>Tema 11</b>	Stigmatizimi dhe politika anti-drogë	<b>8 orë</b>

#### **5. Lënda “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor” (L-26-278-12). Kl. 12 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës “ Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të TIK në shërbimin social-shëndetësor.
- Të përdorin programin (software) e planifikimit të kujdesit në shërbimin social-shëndetësor.
- Të përdorin programin (software) e dokumentimit të kujdesit në shërbimin social-shëndetësor
- Të përdorin programin (software) e regjistrimit dhe raportimit të rezultateve të kujdesit
- Të njohin dhe përdorin programin (software) e planifikimit të kohës së shërbimit, pozicionit dhe vendeve të punës së personelit.
- Të përdorin programin (software) e të dhënat sociale dhe shëndetësore të klientëve, banorëve, pacientëve.
- Të përdorin programin (software) e administrimit ekonomik të klientëve, banorëve, pacientëve.
- Të përshkruajnë ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave.
- Të tregojnë aksesin në network-un social-shëndetësor
- Të përshkruajnë problemet gjatë përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor”, kl.13 - 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Rëndësia e përdorimit të TIK në shërbimin social-shëndetësor	<b>3 orë</b>
<b>Tema 2</b>	Programi (software) i planifikimit të kujdesit në shërbimin social-shëndetësor.	<b>4 orë</b>
<b>Tema 3</b>	Programi (software) i dokumentimit të kujdesit në shërbimin social-	<b>4 orë</b>

	shëndetësor	
<b>Tema 4</b>	Programi (software) i regjistrimit dhe raportimit të rezultateve të kujdesit	<b>4 orë</b>
<b>Tema 5</b>	Programi (software) i planifikimit të kohës së shërbimit, pozicionit dhe vendeve të punës së personelit	<b>4 orë</b>
<b>Tema 6</b>	Programi (software) i të dhënave sociale dhe shëndetsore të klientëve, banorëve, pacientëve	<b>4 orë</b>
<b>Tema 7</b>	Programi (software) i administrimit ekonomik të klientëve, banorëve, pacientëve	<b>4 orë</b>
<b>Tema 8</b>	Ruajtja dhe sigurimi i të dhënave	<b>2 orë</b>
<b>Tema 9</b>	Aksesi në Network-un social-shëndetësor.	<b>2 orë</b>
<b>Tema 10</b>	Problemet gjatë përdorimit të TIK në shërbimin social-shëndetësor.	<b>3 orë</b>

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Hapja dhe mbyllja e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kod</b>	<b>HAPJA DHE MBYLLJA E NJË BIZNESI NË SHËRBIMIN SOCIAL - SHËNDETËSOR</b>	<b>M-17-826-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në shërbimin social social-shëndetësor.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetsore”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi identifikon procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Analiza e përparësive dhe mangësive të llojeve të ndryshme të ideve të biznesit</li><li>- Përzgjedhja e idesë së biznesit</li><li>- Përzgjedhja e llojit të shërbimit apo asistencës social-shëndetësore që do të ofrojë biznesi i ri</li><li>- Analiza e kuadrit ligjor lidhur me biznesin social-shëndetësor</li><li>- Analiza e procedurave për regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit</li><li>- Analiza e procedurave për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve.</li><li>- Analiza e procedurave për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore</li><li>- Analiza e procedurave për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR)</li><li>- Analiza e procedurave për regjistrimin e biznesit në qëndër kombëtare të licensimit (QKL)</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:	

- 
- të bëjë analizën e përparësive dhe mangësive të llojeve të ndryshme të ideve të biznesit
  - të përzgjedhë idenë e hapjes së biznesit (hapja e një biznesi të ri, blerja e një biznesi ekzistues, etj)
  - të përzgjedhë llojin e shërbimit apo asistencës social-shëndetësore që do të ofrojë biznesi i ri
  - të analizojë kuadrin ligjor lidhur me biznesin social-shëndetësor
  - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit
  - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve.
  - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore
  - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR)
  - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të licensimit (QKL)

## **RM 2 Nxënësi harton planin e biznesit**

### ***Përmbajtja:***

- Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të biznesit social-shëndetësor
- Përcaktimi i misionit të biznesit social- shëndetësor
- Analiza e tregut të shërbimit social- shëndetësor
- Hartimi i planit të financimit të biznesit social- shëndetësor
- Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit social- shëndetësor
- Hartimi i planit-marketing të biznesit social-shëndetësor
- Hartimi i planit të menaxhimit të biznesit social-shëndetësor
- Përcaktimi i strukturës organizative të biznesit që do të krijohet.
- Përcaktimi i burimeve njerëzore të biznesit
- Përshkrimi i ekipit menaxhues dhe stafit drejtues
- Përcaktimi i procedurave të rekrutimit të stafit
- Vendosja e emrit të biznesit social-shëndetësor
- Përcaktimi i elementeve përfaqësues të identitetit të sipërmarrjes (logo dhe moto e veprimtarisë së sipërmarrjes)
- Bashkëngjitja e shtojcave të planit të biznesit (artikuj, diagrame, kontrata, informata të detajuara financiare, patentë, informata të produkteve, listë çmimesh, broshura, buletin informativ dhe skica teknike).
- Paraqitja e dokumentacionit dytësor të biznesit
- Hartimi i deklaratës së qëllimit

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë qartë qëllimet dhe objektivat e biznesit social- shëndetësor

- të përcaktojë saktë misionin e biznesit social- shëndetësor
- të bëjë analizën e tregut të shërbimit social- shëndetësor
- të hartojë planin e financimit të biznesit social-shëndetësor
- të përcaktojë vendndodhjen e biznesit social- shëndetësor
- të hartojë planin -marketing të biznesit social-shëndetësor
- të hartojë planin e menaxhimit të biznesit social-shëndetësor
- të përcaktojë saktë strukturën organizative të biznesit që do të krijohet.
- të përcaktojë burimet njerëzore të biznesit
- të përcaktojë ekipin menaxhues dhe stafin drejtues
- të përcaktojë procedurat e rekrutimit të stafit
- të vendosë emrin e biznesit social-shëndetësor
- të përcaktojë elementet përfaqësues të identitetit të sipërmarrjes (logo dhe moto e veprimtarisë së biznesit)
- të bashkëngjitë shtojca të nevojshme të planit të biznesit (artikuj, diagrame, kontrata, informata të detajuara financiare, patentë, informata të produkteve, listën e çmimeve, broshura, buletin informativ dhe skica teknike).
- të paraqesë dokumentacionin dytësor të biznesit (kopja e kontratës së françizës dhe gjitha dokumentet dytësore të siguruar nga koncesionari, kopja e qirasë së propozuar ose marrëveshja e blerjes për ndërtimin e hapësirës, kopje e licencës apo dokumenteve tjera ligjore, kopje e C.V. së stafit drejtues, etj).
- të hartojë deklaratën e qëllimit

### **RM 3 Nxënësi hap biznesin**

#### ***Përmbajtja:***

- Regjistrimi i biznesit në gjykatën e rrethit
- Regjistrimi i biznesit në drejtorinë e tatimeve.
- Regjistrimi i biznesit në drejtorinë e taksave vendore
- Regjistrimi i biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR)
- Regjistrimi i biznesit në qendër kombëtare të licensimit (QKL)
- Hartimi i rregullores së brendshme
- Rekrutimi i stafit
- Promovimi i biznesit të ri
- Hapja e dyerve për komunitetin.
- Komunikimi me klientët e interesuar për shërbimet e qendrës
- Lidhja dhe nënshkrimi i kontratave me klientët

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të simulojë regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit



- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve.
- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore
- të simulojë regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR)
- të regjistrimi i biznesit në qëndër kombëtare të licensimit (QKL)
- të hartojë rregulloren e brendshme të biznesit
- të simulojë rekrutimin e stafit dhe punonjësve
- të promovojë biznesin e ri
- të hapë dyert për komunitetin që të vizitojë qendrën dhe të informohet për të gjitha çështjet që iu interesojnë.
- të komunikojnë me klientët e interesuar për shërbimet e qendrës
- të lidhin dhe nënshkruajnë kontrata me klientët.

#### **RM 4 Nxënësi mbyll biznesin**

##### ***Përmbajtja:***

- Marrja e vendimit për mbylljen e biznesit
- Llogaritja e kostos së procesit të mbylljes së biznesit
- Njoftimi zyrtar administrativ për vendimin për mbylljen e biznesit
- Anullimi i lejes, licencës dhe emrit të biznesit
- Pagimi i taksave dhe borxheve
- Njoftimi i kreditorëve për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i furnitorëve për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i sigurimeve shoqërore për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i partnerëve dhe bashkëpunorëve për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i qiradhënësit për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i stafit dhe punonjësve për mbylljen e biznesit
- Njoftimi i klientëve për mbylljen e biznesit
- Mbyllja e llogarive bankare të biznesit dhe anulimi i kartave të kreditit.
- Përbushja e shërbimeve dhe detyrimeve sipas kontratave dhe mbyllja e projekteve
- Kthimi i çdo depozite apo pagese për shërbime që nuk janë ofruar.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë vendimin për mbylljen e biznesit duke e argumentuar atë
- të llogaritë kostot dhe shpenzimet e procesit të mbylljes së biznesit
- të bëjë njoftimin zyrtar administrativ për vendimin për mbylljen e biznesit
- të bëjë anulimin e lejes, licencës dhe emrit të biznesit
- të paguajë taksat dhe borxhet

- të njoftojë kreditorët për mbylljen e biznesit
- të njoftojë furnitorët për mbylljen e biznesit
- të njoftojë sigurimet shoqërore për mbylljen e biznesit
- të njoftojë partnerët dhe bashkëpunëtorët për mbylljen e biznesit
- të njoftojë qiradhënësin për mbylljen e biznesit sipas kushteve të kontratës
- të njoftojë stafin dhe punonjësit për mbylljen e biznesit jo më vonë se dy javë përpara
- të njoftojë klientët për mbylljen e biznesit
- të kryejë procedurat për mbylljen e llogarive bankare të biznesit dhe anulimin e kartave të kreditit.
- të përmbushë shërbimet dhe detyrimet sipas kontratave të lidhura si edhe mbylljen e projekteve
- të kthejë çdo depozitë apo pagesë për shërbime që nuk janë ofruar.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetsore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore komunitare, etj.
- Mësuesi dhe referenti i qendrës duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur nxënësin në procedurat e përditshme konkrete të institucionit, situata të komplikuar, situata që lidhen me nevoja specifike në rrethana specifike.
- Mësuesi dhe referenti i qendrës duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për nxënësit në mënyrë që ata të simulojnë të gjitha procedurat e hapjes dhe mbylljes së një biznesi në fushën e shërbimeve social - shëndetësore.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për të njohur legjislacionin në fuqi mbi të cilin ngrihet biznesi social-shëndetësor dhe të gjitha procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në fushën e shërbimeve social - shëndetësore.
- Vlerësimin e nevojave aktuale dhe mundësitë që ofron qendra për përmbushjen e tyre.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre..

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.
  - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i
-

---

kontaktit në qendër .

- Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
  - Udhëzuesa, katalogë, rregullore, etj.
-

## 2. Moduli “Menaxhimi i përkujdesjes shëndetësore në një qendër të shërbimit social-shëndetësor”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kod</b>	<b>MENAXHIMI I PËRKUJDESJES SHËNDETËSORE NË NJË QENDËR TË SHËRBIMIT SOCIAL-SHËNDETËSOR</b>	<b>M-17-827-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer hartimin dhe zbatimin e planit të kujdesit dhe të planit të shëndetit, plotësimin e raporteve të ecurisë për çdo klient, kujdesin për jetën sociale në qendër, lidhjet me komunitetin dhe autonominë e zgjedhjes, mbrojtjen e të drejtave të klientëve dhe ushqyerjen e tyre.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	36 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi bën hartimin dhe zbatimin e planit të kujdesit.</b> <b><i>Përmbajtja:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Plotësimi i formularit me të dhënat e klientit.</li><li>- Intervistimi i drejtpërdrejtë i klientit</li><li>- Caktimi një punonjësi për vlerësimin e nevojave</li><li>- Vlerësimi i nevojave mjekësore të klientit</li><li>- Vlerësimi i nevojave jetësore të klientit.</li><li>- Hartimi i raportit mbi gjendjen aktuale të klientit</li><li>- Hartimi i raportit të plotë të vlerësimit të nevojave dhe ecurisë.</li><li>- Shpërndarja e formularëve stafit profesional që punon drejtpërsëdrejti me klientin.</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li><li>- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës</li><li>- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër</li></ul> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të plotësojë me kujdes formularin me të dhënat e klientit.</li><li>- të intervistojë drejtpërdrejtë klientin për</li><li>- të caktojë një punonjës për vlerësimin e nevojave multidisiplinare të klientit.</li><li>- të vlerësojë nevojat mjekësore të klientit së bashku me</li></ul>	

---

ekipet e profesionisteve duke përcaktuar dhe mënyrën e plotësimit të tyre.

- të vlerësojë nevojat jetësore të klientit.
- të hartojë raportin mbi gjëndjen aktuale të klientit
- të hartojë raportin e plotë të vlerësimit të nevojave dhe të ecurisë së klientit.
- të vërë në dispozicion formularët për stafit profesional që punon drejtpërsëdrejti me klientin

## **RM 2 Nxënësi bën hartimin dhe zbatimin e planit të shëndetit**

### ***Përmbajtja:***

- Përshkrimi i shërbimeve shëndetësore në planin e shëndetit
- Përshkrimi i zhvillimeve emocionale, sjelljes dhe identitetit të klientit
- Përshkrimi i paraqitjes dhe aftësive vetëkontrolluese të klientit
- Përshkrimi i nevojave të identifikuara
- Përcaktimi i masave për plotësimin e nevojave të identifikuara
- Përcaktimi i afateve të realizimit, personave përgjegjës dhe rezultateve të pritshme.
- Dokumentimi i të gjitha mjekimeve, trajtimeve dhe ndihmës së parë që marrin klientet
- Respektimi i së drejtës për zgjedhjen e gjinisë së mjekut ose personeli shëndetësor
- Kryerja e procedurave të veçanta shëndetësore me autorizimin dhe porosinë me shkrim të mjekut.
- Vendosja e kontakteve të ngushta me specialistë të shëndetit për nevoja të veçanta shëndetësore
- Ndërgjegjësimi i klientit për rreziqet që sjellin për shëndetin duhanpirja, alkooli dhe përdorimi i substancave të tjera.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë shërbimet shëndetësore në planin e shëndetit
- të përshkruajë zhvillimet emocionale, sjelljen dhe identitetin e klientit
- të përshkruajë saktë paraqitjen dhe aftësitë vetëkontrolluese të klientit
- të përshkruajë nevojat e identifikuara të klientit
- të përcaktojë masat e duhura për plotësimin e nevojave të identifikuara
- të përcaktojë afatet e realizimit, personat përgjegjës dhe rezultatet e pritshme.
- të dokumentojë me kujdes të gjitha mjekimet, trajtimet dhe ndihmën e parë që do marrin klientet

- të respektojë të drejtën për zgjedhjen e gjinisë së mjekut ose të personelit shëndetësor
- të kryejë procedurat e veçanta shëndetësore me autorizimin dhe porosinë me shkrim të mjekut.
- të vendosë kontakte të ngushta me specialistë të shëndetit për nevoja të veçanta shëndetësore
- të ndërgjegjësojë klientin për rreziqet që sjellin për shëndetin duhanpirja, alkooli dhe përdorimi i substancave të tjera.

### **RM 3 Nxënësi plotëson raportin e ecurisë**

#### ***Përmbajtja:***

- Evidentimi i përmbushjes së përgjegjësive gjatë zbatimit të planit të shërbimeve
- Evidentimi i zbatimit të afateve të vlerësimit të gjëndjes
- Evidentimi i progresit të shërbimeve të klientit
- Analiza e zbatimit të planit të shërbimeve
- Rishikimi i planit të shërbimeve
- Pasqyrimi i ndryshimeve dhe rekomandimeve të ekspertëve në planet e kujdesit të klientit
- Përfshirja e klienteve në procesin e analizës dhe rishikimit të planeve

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë përmbushjen e përgjegjësive gjatë zbatimit të planit të shërbimeve
- të evidentojë zbatimin e afateve të vlerësimit të gjëndjes
- të evidentojë progresin e shërbimeve të klientit
- të analizojë zbatimin e planit të shërbimeve
- të rishikojë planin e shërbimeve
- të pasqyrojë ndryshimet dhe rekomandimet e ekspertëve në planet e kujdesit të klientit
- të sigurojë përfshirjen e klienteve në procesin e analizës dhe rishikimit të planeve

---

### **RM 4 Nxënësi përkujdeset për jetën sociale në qendër, lidhjet me komunitetin dhe autonominë e zgjedhjes.**

#### ***Përmbajtja:***

- Hartimi i planit të aktiviteteve sociale
- Rishikimi i përmuajshëm i planit të aktiviteteve sociale
- Krijimi i kushteve për përfshirjen e klientëve në aktivitete të shumëllojshme në grup
- Respektimi i së drejtës së klientëve që të presin vizitorë dhe të marrin pjesë në aktivitete dhe gëzime familjare.
- Respektimi i së drejtës së klientëve për të vendosur për jetën e tyre dhe për të përfituar ndihmën e kërkuar.
- Përfshirja e klientit në mendimarrjen për shërbimet dhe rregullat e vendosura, për orarin e ngrënies, aktiviteteve,

---

orarin e fjetjes, pritjes së vizitorëve etj

- Nxitja e autonomisë së zgjedhjes

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë planin e aktiviteteve sociale në bashkëpunim me klientët.
- të bëjë rishikimin e përmuajshëm të planit të aktiviteteve sociale
- të krijojë kushtet për përfshirjen e klientëve në aktivitete të shumëllojshme në grup sipas zgjedhjes së tyre.
- të respektojë të drejtën e klientit për të pritur vizitorë dhe të marrë në aktivitete dhe gëzime familjare
- të respektojë të drejtën e klientit për të vendosur për jetën e tyre dhe për të përfituar ndihmën e kërkuar.
- të përfshijë klientin në mendimarrjen për shërbimet dhe rregullat e vendosura për orarin e ngrënies, aktiviteteve, orarin e fjetjes, pritjes së vizitorëve etj
- të nxisë tek klientët autonominë e zgjedhjes

**RM 5 Nxënësi respekton të drejtat, intimitetin dhe dinjitetin e klientëve.**

**Përmbajtja:**

- Zbatimi i të drejtave ligjore të mbrojtjes nga abuzimet financiare, psikologjike, fizike dhe seksuale.
- Identifikimi i informacionit dhe procedurave për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitet të klientit
- Krijimi i kushteve për sigurimin e intimitetit gjatë kryerjes së shërbimeve të higjienës tek klientët që janë të aftë fizikisht.
- Krijimi i mundësisë që klientet të marrin pjesë në procesin politik dhe në votime sipas dëshirës.
- Zbatimi i kriterëve dhe sanksioneve për presonelin në shkelje të rregulloreve të brendshme.
- Raportimi i rasteve të abuzimit dhe referimi tek personat/organet kompetente që merren me ankesën.
- Inspektimi i ankesave me seriozitet dhe në kohën e duhur.
- Nxitja e pavarësisë së klientit për shërbime të kujdesit higjienik
- Programimi i procedurave të posaçme për shërbimet që ofrohen për intimitetin e klientit gjatë shërbimeve personale.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë të drejtat ligjore të mbrojtjes nga abuzimet

- financiare, psikologjike, fizike dhe seksuale.
- të identifikojë informacionin dhe procedurat e duhura për të siguruar respektimin e të drejtave për intimitet të klientit
- të ndihmojë në sigurimin e intimitetit gjatë kryerjes së shërbimeve të higjienës tek klientet që janë aftë fizikisht.
- të ndihmojë në krijimin e mundësisë që klientët të marrin pjesë në procesin politik dhe në votime sipas dëshirës.
- të ndihmojë në zbatimin e kritereve dhe sanksioneve për personelin në shkelje të rregulloreve të brendshme.
- të bëjë raportimin e rasteve të abuzimit dhe referimi tek personat/organet kompetente që merren me ankesën.
- të ndihmojë në inspektimin e ankesave me seriozitet dhe në kohën e duhur.
- të nxisë pavarësinë për shërbimet e kujdesit higjienik duke zbatuar planin e kujdesit
- të zbatojë programimin e procedurave të posaçme për shërbimet që ofrohen për intimitet të klientit gjatë shërbimeve personale.

**RM 6 Nxënësi siguron vaktet e ngrënies dhe përkujdeset për ushqyerjen e klientit**

***Përmbajtja:***

- Identifikimi i klientëve me kërkesa ushqimore të veçanta.
- Hartimi i menisë ushqimore për klientët.
- Hartimi i listës ushqimore të institucionit.
- Hartimi i buxhetit të institucionit.
- Furnizimi i institucionit me produkte ushqimore.
- Përfshirja e klientëve në planifikimin e menisë, blerjen e ushqimeve, përgatitjen e vakteve, orarin e ngrënies dhe shtrimin e tavolinës për ngrënie.
- Zbatimi i kërkesave individuale ushqimore të klientëve
- Ushqyerja e klienteve në rast të pamundësisë së tyre.
- Intervistimi i klienteve për plotësimin e standardeve të ushqimit të tyre.
- Respektimi i së drejtës së klientit për mbajtjen e disa ushqimeve e përgatitjen e një pijeje për vete dhe për vizitorët e tij.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë klientët me kërkesa të veçanta ushqimore
- të hartojë meninë ushqimore për klientët në përputhje me kërkesat dietike individuale dhe kërkesat ushqimore të moshës dhe gjëndjes shëndetësore.
- të hartojë listën ushqimore të institucionit duke patur parasysh sasinë e cilësinë ushqimore për klientët me nevoja dietike të veçanta.
- të sigurojë furnizimin e institucionit me të gjitha produktet ushqimore të planifikuara



- të përfshijë klientët në planifikimin e menisë, blerjen e ushqimeve, përgatitjen e vakteve, orarin e ngrënies dhe shtrimin e tavolinës për ngrënie.
- të përgatisë vaktet duke zbatuar kërkesat individuale ushqimore të klientëve në përputhje me kërkesat dietike dhe ushqimore të moshës dhe gjëndjes shëndetësore.
- të ushqejë klientët në rast të pamundësisë së tyre.
- të intervistojë klientët për plotësimin e standardeve të ushqimit të tyre.
- të respektojë të drejtën e klientit për të mbajtur disa ushqime e për të përgatitur pije për vete dhe për vizitorët e tij.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetsore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore komunitare, etj.
- Mësuesi duhet të përzgjedhë me kujdes dhe të vendosë kontakte me institucione të ndryshme që ofrojnë shërbime social-shëndetësore.
- Mësuesi së bashku me referentin/ personin e kontaktit duhet të përpilojë formularët e vlerësimit dhe detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër.
- Mësuesi së bashku me referentin/ personin e kontaktit shoqëron secilin nxënës në prezantimin e parë me klientin
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendër dhe të ketë kontakte të vazhdueshme për të vlerësuar procesin e përfitimit të njohurive dhe aftësive praktike

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.
  - Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyre institucioneve
  - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër .
  - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
  - Udhëzuesa, katalogë, rregullore, etj.
-

### 3. Moduli “Mirëmbajtja e qendrës së shërbimit social - shëndetësor dhe administrimi i dokumentacionit të saj”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	<b>MIRËMBAJTJA E QENDRËS SË SHËRBIMIT SOCIAL - SHËNDETËSOR DHE ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT TË SAJ</b>	<b>M-17-828-12</b>
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer sistemimin e mjediseve dhe pajisjeve, mirëmbajtjen dhe shërbimet ndihmëse, si edhe administrimin e dokumentacionit të një qendre të shërbimit social - shëndetësor.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi sistemon mjediset dhe pajisjet e qendrës së shërbimit social – shëndetësor.</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përcaktimi i mjediseve të përbashkëta për ndenje, aktivitete, ngrënie etj.</li><li>- Mobilimi i dhomës së gjumit së klientëve</li><li>- Pranimi për mbajtjen e sendeve personale</li><li>- Furnizimi i rregullt me ujë, elektricitet dhe ngrohje/freskim.</li><li>- Plotësimi i kushteve higjieno-sanitare dhe mbrojtjes nga zjarri</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li><li>- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës</li><li>- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përcaktojë ambjentet e përbashkëta për ndenje, aktivitete, ngrënie etj, sipas manualit përkatës</li><li>- të kryejë mobilimin e dhomës së gjumit duke patur parasysh plotësimin e nevojave jetike të klientëve.</li><li>- të pranojë mbajtjen e sendeve personale të klientëve</li><li>- të interesohet për furnizimin e rregullt me ujë, elektricitet dhe ngrohje/freskim.</li><li>- të interesohet për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe mbrojtjes nga zjarri</li></ul>	

**RM 2 Nxënësi kryen mirëmbajtjen dhe shërbimet ndihmëse të qendrës së shërbimit social - shëndetësor**

***Përmbajtja:***

- Mirëmbajtja e aparaturave dhe teknikës
- Administrimi i shërbimeve
- Vlerësimi i gjendjes higjieno - sanitare të mjediseve të qendrës, dhomave, tualeteve, oborrit, kopshtit etj.
- Kryerja e shërbimit të hotelerisë për sigurimin e ushqyerjes, fjetjes dhe rregullimit të dhomave
- Kryerja e shërbimit të lavanterisë dhe mirëmbajtjes së veshjeve, mbulesave, perdeve, teshave etj.
- Kryerja e shërbimit të transportit për klientët.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i azilit
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mirëmbajë aparaturat dhe teknikën e qendrës së shërbimit social – shëndetësor
- të kryejë administrimin e shërbimeve sipas organigramës së personelit .
- të vlerësojë gjendjen higjieno - sanitare të mjediseve të qendrës, dhomave, tualeteve, oborrit, kopshtit etj.
- të kryejë shërbimin e hotelerisë për sigurimin e ushqyerjes, fjetjes dhe rregullimit të dhomave.
- të kryejë shërbimin e lavanterisë dhe mirëmbajtjes së veshjeve, mbulesave, perdeve, teshave etj.
- të kryejë shërbimin e transportit për klientët.

**RM 3 Nxënësi administron dokumentacionin e qendrës**

***Përmbajtja:***

- Identifikimi i rregullave për administrimin e dokumentacionit të qendrës
- Organizimi dhe sistemimi i dokumentacionit.
- Sigurimi i dokumentacionit
- Arkivimi i dokumentacionit
- Verifikimi i dokumentacionit
- Vlerësimi i dokumentacionit
- Inspektimi i dokumentacionit
- Garantimi i konfidencialitetit të dokumentacionit të klientit dhe të personelit.
- Zbatimi i legjislacionit përkatës për administrimin e dokumentacionit në qendër

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë rregullat për administrimin e dokumentacionit të qendrës
- të organizojë dhe sistemojë dokumentacionin sipas kriterëve përkatëse
- të sigurojë dokumentacionin sipas rregullave të sigurisë
- të arkivojë dokumentacionin sipas rregullave të arkivës
- të verifikojë dokumentacionin
- të vlerësojë dokumentacionin sipas kriterëve përkatëse
- të inspektojë dokumentacionin sipas rregullave
- të garantojë konfidencialitetin e dokumentacionit të klientit dhe të personelit.
- të zbatojë legjislacioni përkatës për administrimin e dokumentacionit në qendër

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetsore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore komunitare, etj.
- Mësuesi/personeli i qendrës duhet të përzgjedhë me kujdes që nxënësi të vendos kontakte miqësore me klient të përshtashëm duke respektuar pëlqimin e këtij të fundit
- Mësuesi dhe personeli i qendrës duhet të shoqërojë secilin nxënësi në prezantimin e parë me klientin.
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendra dhe të ketë kontakte të vazhdueshme për procesin e përfitimit të njohurive dhe zbatimit të aftësive praktike.
- Nxënësi kryen veprimet e tij mundësisht gjithnjë me të njëjtin klient.
- Nxënësit i duhet krijuar mundësia të marrë pjesë në administrimin e dokumentacionit të qendrës.
- Moduli testohet në qendër.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njerëzit në nevojë.
  - Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyre institucioneve
  - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njerëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër.
  - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
  - Dokumentacioni përkatës i qendrës
  - Udhëzuesa, katalogë, rregullore, etj.
- 



#### 4. Moduli “Rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	<b>REKRUTIMI I STAFIT DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE</b>	<b>M-17-829-12</b>
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të kryer procedurat e rekrutimit të stafit, organizimin e vogël të punës si edhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të cilësisë.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit të stafit</b> <b><i>Përmbajtja:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shpallja publike e kërkesës për vende pune</li><li>- Pranimi i kërkesave të detajuara për kandidatin dhe pozicionin vakant të punës</li><li>- Grumbullimi dhe shqyrtimi i aplikimeve</li><li>- Përzgjedhja fillestare e kandidatëve bazuar në aplikimet e mbërritura</li><li>- Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur për fazën e parë të intervistimit</li><li>- Zhvillimi i intervistave</li><li>- Kryerja e testeve të ndryshme logjike dhe profesionale</li><li>- Përzgjedhja e kandidatëve fitues nga faza e parë e intervistimit</li><li>- Zhvillimi i fazës së dytë të intervistimit me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të bordit drejtues të biznesit</li><li>- Përzgjedhja e kandidatit fitues</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li><li>- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës</li><li>- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër</li></ul> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të shpallë publikisht njoftimin për vendet bosh sipas procedurave përkatëse</li><li>- të pranojë kërkesat e detajuara për kandidatin dhe pozicionin vakant të punës</li><li>- të kryejë grumbullimin dhe shqyrtimin e aplikimeve</li><li>- të kryejë përzgjedhjen fillestare të kandidatëve bazuar në aplikimet e mbërritura</li></ul>	

- të njoftojë kandidatët e përzgjedhur për fazën e parë të intervistimit
- të marrë pjesë në zhvillimin e intervistave
- të marrë pjesë në kryerjen e testeve të ndryshme logjike dhe profesionale
- të përzgjedhë kandidatët fitues nga faza I e intervistimit
- të zhvillojë fazën e dytë të intervistimit me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të bordit drejtues të biznesit
- të përzgjedhë kandidatin fitues në përputhje me përshkrimin e vendit të punës

## **RM 2 Nxënësi menaxhon burimet njerëzore**

### ***Përmbajtja:***

- Hartimi i përshkrimit të punës për të gjitha pozicionet
- Përcaktimi i niveleve të kualifikimit dhe pagesave për çdo pozicion pune
- Hartimi i politikave dhe procedurave të detajuara në menaxhimin e burimeve njerëzore
- Vlerësimi i performancës së punonjësve
- Identifikimi i potencialeve maksimale të secilit punonjës
- Menaxhim total i cilësisë
- Përcaktimi i kompensimeve dhe benefiteve
- Kryerja e sondazheve të herëpashershme mbi cilësinë e punës së personelit
- Planifikimi i trajnimeve të ndryshme sipas nevojave

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i azilit
- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mirëmbajë aparataturat dhe teknikën e qendrës së shërbimit social – shëndetësor
- të kryejë administrimin e shërbimeve sipas organigramës së personelit .
- të vlerësojë gjendjen higjieno - sanitare të mjediseve të qendrës, dhomave, tualeteve, oborrit, kopshtit etj.
- të kryejë shërbimin e hotelerisë për sigurimin e ushqyerjes, fjetjes dhe rregullimit të dhomave.
- të kryejë shërbimin e lavanterisë dhe mirëmbajtjes së veshjeve, mbulesave, perdeve, teshave etj.
- të kryejë shërbimin e transportit për klientët.

## **RM 3 Nxënësi bën organizimin e vogël të punës në qendër**

### ***Përmbajtja:***

- Hartimi dhe afishimi i organigramës
- Hartimi dhe afishimi i planit të shërbimit
- Caktimi i personit përgjegjës për kontrollin e cilësisë së shërbimeve
- Caktimi i personit përgjegjës për sigurimin e ushqyerjes

- Caktimi i personit përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e higjienës.
- Caktimi i personit përgjegjës për manipulimet specifike mjekësore
- Caktimi i personit përgjegjës për administrimin e produkteve farmaceutike
- Përzgjedhja e drejtuesit të personelit të shërbimit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyre referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë hartimin dhe afishimin e organigramës
- të kryejë hartimin dhe afishimin e planit të shërbimit në përputhje me kodin e punës
- të caktojë personin përgjegjës për kontrollin e cilësisë së shërbimeve
- të caktojë personin përgjegjës për sigurimin e ushqyerjes
- të caktojë personin përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e higjienës.
- të caktojë personin përgjegjës për manipulimet specifike mjekësore
- të caktojë personin përgjegjës për administrimin e produkteve farmaceutike
- të përzgjedhë drejtuesin e personelit të shërbimit.

**RM 4 Nxënësi menaxhon sigurimin e cilësisë**

***Përmbajtja:***

- Zhvillimi i komunikimit të brendshëm
- Zbatimi i strukturës komunikative dhe procesit të reflektimit në funksion të organizimit
- Kryerja e takimeve periodike të gjithë ekipit
- Kryerja e takimeve periodike të stafit drejtues.
- Formimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personave përgjegjës
- Kryerja e takimeve profesionale sipas sektoreve dhe përgjegjësi përkatese.
- Përshtatja dhe modifikimi i përkujdesjes për qendra rezidenciale, ditore si dhe direkt në familje.
- Zbatimi i vazhdueshëm i procesit të raportimit.
- Përpunimi dhe zhvillimi i standarteve dhe udhëzimeve aktuale
- Hartimi i pyetësorëve për vizitorët dhe familjarët dhe i
- Administrimi i ankesave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyre referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbështetë zhvillimin e komunikimit të brendshëm
- të mbështetë zbatimin e strukturës komunikative dhe procesin e reflektimit në funksion të organizimit
- të ndihmojë në realizimin e takimeve periodike të gjithë ekipit
- të ndihmojë në realizimin e takimeve periodike të stafit drejtues.
- të mbështetë formimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personave përgjegjës
- të ndjekë takimet profesionale sipas sektoreve dhe përgjegjësi përkatese.
- të bëjë përshtatjen dhe modifikimin e përkujdesje për qendra rezidenciale, ditore si dhe direkt në familje.
- të bëjë zbatimin e vazhdueshëm të procesit të raportimit.
- të mbështetë përpunimin dhe përmirësimin e standarteve dhe udhëzimeve aktuale
- të marrë pjesë në hartimin e pyetësorëve për vizitorët dhe familjarët
- të kryejë administrimin e ankesave.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes social-shëndetësor, qendër ditore ose rezidenciale të cilat ofrojnë shërbime social-shëndetsore, shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore komunitare, etj.
- Mësuesi duhet të për zgjedhë me kujdes dhe të vendosë kontakte me institucione të ndryshme që ofrojnë këto shërbime.
- Mësuesi duhet të përpilojë listën e nxënësve që do vizitojnë institucionet dhe të shoqërojë seicilin grup në prezantimin e parë.
- Mësuesi duhet të bëjë vizita sa më të shpeshta në qendra dhe të këtë kontakte të vazhdueshme për procesin.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare si dhe direkt në familje për njërëzit në nevojë.
  - Të sigurohet një marrëveshje tip midis shkollës dhe këtyre institucioneve
  - Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset, institucionet, qendrat si dhe shoqata që ofrojnë shërbime social-shëndetsore ditore, rezidenciale, komunitare sidhe direkt në familje për njërëzit në nevojë ku do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me referentin/presoni i kontaktit në qendër.
  - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
  - Dokumentacioni përkatës i qendrës
  - Udhëzuesa, katalogë, rregullore, etj.
- 





## 5. Moduli “Ndërtimi i network-ut social-shëndetësor dhe pjesëmarrja në shoqërinë civile”

**Drejtimi:** Shërbime sociale dhe shëndetësore  
**Niveli:** III  
**Klasa:** 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kod</b>	<b>NDËRTIMI I NETWORK-UT SOCIAL-SHËNDETËSOR DHE PJESËMARRJA NË SHOQËRINË CIVILE</b>	<b>M-20-830-12</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Ky modul i aftëson nxënësit për të qënë të aftë të ndërtojnë network social-shëndetësor dhe për të marrë pjesë aktive në veprimtaritë e shoqërisë civile.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	33 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi planifikon ndërtimin e network-ut social - shëndetësor</b>  <b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analiza e rrjeteve dhe kooperimeve social-shëndetësore</li> <li>- Analiza e kuadrit dhe hapësirave ligjore</li> <li>- Vlerësimi i kriteve për një kooperim social-shëndetësor të sukseshëm</li> <li>- Formulimi i qëllimit të biznesit</li> <li>- Përcaktimi i lidhjeve ideale për ecurinë e biznesit</li> <li>- Përcaktimi i elementeve identifikues të biznesit (emrit dhe tipit të biznesit) në këtë network</li> <li>- Përshkrimi i profilit të biznesit (sektori / grupet e interesit, pikat e forta, rëndësia etj)</li> <li>- Përshkrimi i shërbimeve që mund të ofrosh për të ndihmuar njerëzit</li> <li>- Përshkrimi i asaj se çfarë kërkon nga këta njerëz</li> <li>- Planifikimi i datave dhe detyrave</li> <li>- Planifikimi i synimeve dhe pritshmërive nga ky network</li> <li>- Planifikimi i afateve kohore</li> <li>- Krahasimi i kësaj mënyre marketingu me veprimtaritë e tjera marketing</li> <li>- Sigurimi i besueshmërisë dhe vazhdueshmërisë.</li> </ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li> </ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b>            Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojë me kujdes rrjetet dhe kooperimet social-shëndetësore</li> <li>- të analizojë me kujdes kuadrin dhe hapësirat ligjore</li> </ul>	

- 
- lidhur me të bërit network
  - të vlerësojë kriteret për një kooperim social-shëndetësor të sukseshëm
  - të ndërtojë kooperative social-shëndetësore duke zbatuar etapat
  - të organizojë kooperative social-shëndetësore
  - të drejtojë dhe menaxhojë kooperative social-shëndetësore
  - të sigurojë besueshmërinë dhe vazhdueshmerinë

## **RM 2 Nxënësi ndërton network-un social - shëndetësor**

### ***Përmbajtja:***

- Përzgjedhja e tipit të network–ut që përshtatet me biznesin
- Prezantimi i vetvetes dhe i biznesit në këtë network
- Prezantimi i risive që sjell ky biznes në tregun social – shëndetësor
- Prezantimi i prioriteteve për të ndihmuar njerëzit në nevojë
- Ndërtimi i besimit dhe reputacionit të biznesit
- Ruajtja e integritetit
- Mbajtja e kontakteve me grupet e interesit, partnerët dhe klientët
- Ndjekja dhe menaxhimi i vazhdueshëm i networkut

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyre referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë me kujdes tipin e network –ut që përshtatet me biznesin
- të prezantojë në mënyrë bindëse vetveten dhe biznesin në këtë network
- të prezantojë në mënyrë të veçantë risitë që sjell ky biznes në tregun social – shëndetësor
- të prezantojë pikat e forta të biznesit krahasuar me konkurrencën
- të prezantojë si prioritet kryesor të krijimit të network-ut ndihmën ndaj njerëzve në nevojë
- të përkushtohet në ndërtimin e besimit dhe reputacionit të biznesit
- të sigurojë integritetin personal dhe të biznesit
- të mbajë kontakte të vazhdueshme me grupet e interesit, partnerët dhe klientët
- të realizojë ndjekjen dhe menaxhimin e vazhdueshëm të networkut

## **RM3 Nxënësi merr pjesë aktive në shoqërinë civile.**

### ***Përmbajtja:***

- Pjesëmarrja qytetare në aksionet e shoqërisë civile.
- Mështetja e traditës shoqërore kombëtare dhe

- implementimi i eksperiencave europiane .
- Respektimi i vlerave humane dhe normave morale të shoqërisë
- Kooperimi dhe partneriteti i organizatave në shoqërinë civile.
- Ndërtimi i kulturës dhe formave të reja të bashkëjetesës shoqërore ndërmjet organizatave, shoqatave etj.
- Ndërtimi i dialogut konstruktiv në funksion të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit.
- Mbështetja konkrete e eksperiencave, modeleve dhe shëmbujve të sukseshëm social.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës
- Detyre referimi me shkrim për punën e kryer në qendër

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbështet pjesëmarrjen qytetare në aksionet e shoqërisë civile.
- të mbështet traditën shoqërore kombëtare dhe implementimin e eksperiencave europiane .
- të kontribuojë në respektimi e vlerave humane dhe normave morale të shoqërisë
- të marr pjesë në kooperimin dhe partneritetin e organizatave të shoqërisë civile.
- të kontibujë në ndërtimin e kulturës dhe formave të reja të bashkëjetesës shoqërore ndërmjet organizatave, shoqatave etj.
- të ndjek ndërtimin e dialogut konstruktiv në funksion të përmirësimit dhe ndryshimit të legjislacionit.
- të mbështet konkretisht eksperiencat, modelet dhe shëmbujt e sukseshëm social.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul mund të zbatohet në klasë, në qendra social-shëndetësore gjithashtu dhe në organizata të shoqërisë civile .
- Mësuesi informon nxënësit për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në jetën shoqërore, i motivon ata të hulumtojnë në këtë fushë dhe të formojnë konceptin e tyre.
- Testimi i këtij moduli të mund të bëhet në formën e panairit të ideve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasa të organizohet në formën e një mjedisi ku realizohen marrëdhënie interaktive
  - Mundësimi i shfaqjes së prezantimeve elektronike dhe posterave të përgatitur nga vetë nxënësit
  - Promovimi i aksioneve dhe organizatave me të sukseshme të shoqërisë civile.
-

## 6. Moduli “Zhvillimi i marketingut në biznesin social shëndetësor”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore  
Niveli: III  
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	ZHVILLIMI I MARKETINGUT NË BIZNESIN SOCIAL-SHËNDETËSOR	M-17-831-12
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të praktikuar zhvillimin e marketingut në një biznes social – shëndetësor.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga profilet mësimore të nivelit II të kualifikimit në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi harton përmbledhjen ekzekutive të planit marketing</b> <b><i>Përmbajtja:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pasqyrimi i objektivave</li><li>- Pasqyrimi i strategjive</li><li>- Pasqyrimi i parashikimeve për shitjet</li><li>- Pasqyrimi i tregjeve</li><li>- Pasqyrimi i analizave financiare</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li><li>- Formularë vlerësimi të plotësuar nga stafi i qendrës</li><li>- Detyrë referimi me shkrim për punën e kryer në qendër</li></ul> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të pasqyrojë qartë objektivat e biznesit</li><li>- të pasqyrojë qartë strategjitë që ndiqen</li><li>- të pasqyrojë saktë parashikimet për shitjet</li><li>- të pasqyrojë tregjet aktuale</li><li>- të pasqyrojë saktë analizat financiare</li></ul> <b>RM 2 Nxënësi analizon biznesin aktual social - shëndetësor</b> <b><i>Përmbajtja:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Analiza e bizneseve që ofrojnë shërbimeve social - shëndetësore</li><li>- Analiza e pikave kyçe të konkurrencës</li><li>- Analiza e ofruesve të shërbimeve social - shëndetësore</li><li>- Analiza e mjedisit ligjor</li><li>- Analiza e grupeve të synuara për të qënë klientë të biznesit social - shëndetësor</li><li>- Përcaktimi i vendit që do zërë sipërmarrja që do themelohet</li></ul>	

në tregun e shërbimeve social - shëndetësore

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë bizneset që ofrojnë shërbime social - shëndetësore
- të analizojë pikave kyçe të konkurrencës
- të analizojë ofruesit e shërbimeve social - shëndetësore
- të analizojë mjedisin ligjor përkatës
- të analizojë grupet e synuara për të qënë klientë të biznesit social - shëndetësor
- të përcaktojë saktë vendin që zë kjo sipërmarrje në tregun e biznesit social - shëndetësor

**RM 3 Nxënësi bën analizën e tregjeve të synuara**

**Përmbajtja:**

- Përshkrimi i shërbimeve që do ofrojnë biznesi i ri
- Përcaktimi i objektivave të secilit prej klientëve
- Përshkrimi demografik i grupeve të synuara për klientë
- Identifikimi i tendencave sociale që ndikojnë te klientët
- Përcaktimi i gupeve të synuara nga pikëpamja e nevojave që kanë

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë me kujdes shërbimet që ofron biznesi i ri
- të përcaktojë qartë objektivat për secilin prej klientëve
- të bëjë përshkrimin demografik të grupeve të synuara për klientë, duke u përqëndruar të niveli i të ardhurave, interesat, aktivitetet, niveli i jetesës, përshkrimet e tjera gjeografike, mjedisi politik, situata familjare, mosha etj
- të përcaktojë tendencat sociale që mund të ndikojnë te klientët
- të përcaktojë gupet e synuara nga pikëpamja e nevojave që kanë duke u përqëndruar në atë çfarë klientët duan dhe në përfitimet përkatëse që marrin nga shërbimi

**RM4 Nxënësi harton strategjinë marketing**

**Përmbajtja:**

- Pozicionimi i produktit në lidhje me konkurentët dhe në sytë e klientëve
- Përshkrimi i strategjisë së përgjithshme e cila do të përdoret për të përhapur objektivat dhe misionin
- Përshkrimi i marketingut mix të produkteve
- Vlerësimi i hedhjes në treg të produkteve
- Përcaktimi i strategjisë së çmimeve për çdo produkt.
- Përcaktimi i veprimtarive promovionale

**Instrumentet e vlerësimit:**



- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pozicionojë qartë produktin në lidhje me konkurentët dhe në sytë e klientëve
- të përshkruajë strategjitëe përgjithshmetë cilat do të përdoren për të përhapur objektivat dhe misionin e biznesit
- të përshkruajë marketingun mix të produkteve, duke përfshirë programet marketing specifik (4P)
- të bëjë vlerësimin paraprak të hedhjes në treg të produkteve
- të përcaktojë strategjinë e çmimeve për çdo produkt.
- të përcaktojë veprimtaritë promocionale për promovimin e biznesit

**RM5 Nxënësi zbaton planin marketing**

***Përmbajtja:***

- Hartimi i një plan -veprimi të përditshëm për ndjekjen e realizimit të planit marketing
- Identifikimi i pengesave të mundshme në arritjen e qëllimeve
- Ndjekja e përditshme e realizimit të planit marketing
- Kryerja e marketingut nëpërmjet internetit
- Ruajtja e imazhit të sipërmarrjes social-shëndetësore
- Promovimi i shërbimeve që ofron qendra social – shëndetësore
- Kontaktimi i vazhdueshëm i tregut social-shëndetësor
- Orientimi dhe motivimi i bashkëpunëtorëve dhe i partnerëve.
- Publikimi dhe reklamimi i qendrës, biznesit në sistemin kombëtar dhe ndërkombëtar social- shëndetësor

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një plan -veprimi të përditshëm për ndjekjen e realizimit të planit marketing
- të identifikojë në kohë pengesat e mundshme në arritjen e qëllimeve
- të ndjekë përditë realizimin e planit marketing
- të kryejë marketingun nëpërmjet internetit
- të kujdeset për ruajtjen e imazhit të biznesit social-shëndetësor
- të bëjë promovimin e biznesit social – shëndetësor nëpërmjet veprimtarive të planifikuara në planin marketing
- të mbajë kontaktetë vazhdueshme me tregun social-shëndetësor
- të bëjë orientimin dhe motivimin e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve.

- të bëjë publikimin dhe reklamimin e biznesit në sistemin kombëtar dhe ndërkombëtar social- shëndetësor

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul mund të zbatohet në klasë në qendra social-shëndetësore gjithashtu dhe në organizata të shoqërisë civile .
- Mësuesi ose specialisti i biznesit demonstroi hartimin e një plani marketing për një biznes të dhën social – shëndetësor.
- Nxënësit duhet të aktivizohen në situara konkrete ku duhet të hartojnë vetë një plan marketing për një biznes të dhënë social-shëndetësor.
- Mësuesi ose specialisti përkatës i biznesit vlerësojnë nxënësit për hartimin e një plani marketing të plotë dhe të përshtatshëm.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Klasa ose mjediset e një biznesi social- shëndetësor
  - Mundësimi i vënies në dispozicion të nxënësve i dokumentacionit dhe informacionit të duhur të biznesit për të hartuar planin marketing
  - Formate të gatshme të strukturës së një plani marketing
  - Mjete kancelarie, etj.
-